

VENDIM
Nr. 619, datë 1.11.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I LUMIT GJANICË, FAZA II, SEGMENTI NGA ISH-URA ME SHKALLË DERI TEK URA E SHEQIT”, FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i lumit Gjanicë, faza II, segmenti nga ish-Ura me Shkallë deri tek Ura e Sheqit”, Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 64 006 655 (gjashtëdhjetë e katër milionë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 64 006 655 (gjashtëdhjetë e katër milionë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Fier.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Fier, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Fier, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIMI I LUMIT GJANICA, FAZA II, SEGMENTI NGA ISH-URA ME SHKALLË DERI TEK URA E SHEQIT”, FIER

Nr.	Emër Atësia Mbiemër	Zona kad.	Nr. pas.	Sip. totale e pasurisë (m ²)	Sip. e objektit të banimit (m ²)	Sip. e truallit (m ²)	Sip. e objektit të shërbimit (m ²)	Çmimi i objektit të banimit (l/m ²)	Çmimi i truallit (l/m ²)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lek)	Vlera e objektit të banimit (lek)	Vlera e truallit (lek)	Vlera totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lek)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
1	Gezim Meçe	8532	6/666	550		550			12458		-	6,851,900	6,851,900	Me certifikatë pronësie
2	Lumturi Hamdi Meçe, Genci Xhevat Meçe, Ermira Xhevat Malasi	8532	6/667	34		34			12458		-	423,572	423,572	Me certifikatë pronësie
3	Klanda Lena dhe Irena Skëndaj	8532	6/552	300		300			12458		-	3,737,400	3,737,400	Me certifikatë pronësie
4	Merushe Gjoedeshi, Artur Sabri Gjoedeshi, Neritan Gjoedeshi, Flora Sabri Gjoedeshi, Natasha Sabri Gjoedeshi, Arben Sabri Gjoedeshi	8532	6/253	300		300			12458		-	3,737,400	3,737,400	Me certifikatë pronësie
5	Olimbi Kilo Gjeçi, Niko Kilo Gjeçi, Kozma Kilo Gjeçi, Afroviti Kilo Gjeçi, Parashqevi Kilo Gjeçi, Vllasji Kilo Gjeçi, Dhorri Kilo Gjeçi, Foto Kilo Gjeçi, Grigor Kilo Gjeçi.	8532	6/548	1300		346			12458		-	4,310,468	4,310,468	Me certifikatë pronësie
6	Elis Kuçi dhe Blerina Kuçi	8532	13/203	414		80.2			12458		-	999,132	999,132	Me certifikatë pronësie
7	Vjollca Breca dhe Luan Breca	8532	13/202	413		62.6			12458		-	779,871	779,871	Me certifikatë pronësie
8	Isa Dobra	8532	13/201	413		71.3			12458		-	888,255	888,255	Me certifikatë pronësie
9	Bashkim Rakipaj	8531	1/206	300	105.7	194.3		52,062	12458		5,502,929	2,420,589	7,923,518	Me certifikatë pronësie
10	Agim Kamberaj	8531	1/199	170		170			12458		-	2,117,860	2,117,860	Me certifikatë pronësie
11	Nuri Sako	8532	6/48	1260		355.8			12458		-	4,432,556	4,432,556	Me certifikatë pronësie
12	Kristaq Goga, Dhoksie Goga, Niko Goga, Eglantina Goga	8531	1/529-ND	0	315.5			52,061.77			16,425,488		16,425,488	Me certifikatë pronësie
13	Faslli Lika, Xhevdet Lika	8531	1/133	500.14		500.14			12458		-	6,230,744	6,230,744	Me certifikatë pronësie
14	Vitori Beta, Arben Beta, Arjan Beta, Alketa Beta	8531	1/133-ND	0	130.0			52,061.77			5,148,490	-	5,148,490	Me certifikatë pronësie
SHUMA TOTALE													64,006,655	

Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Vlerësimi i objekteve të banimit është bërë me çmimin mesatar të shitblerjeve për tre muajt e fundit, referuar shkresës nr. 8732/3 prot., datë 28.10.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier. Vlerësimi i pasurisë “objekt shërbimi”, është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, i ndryshuar